

453  
05.03.2019



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË SË UST**

Tiranë, më 04.03.2019

Drejtuar: **Rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës**

**Prof. Dr. Agron CUKA**

Lënda : **Raporti i Punës për Muajin Shkurt i NJBSC-së pranë UST.**

**R A P O R T**

Gjatë muajit Shkurt 2019 Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së UST (NJSBC), e përbërë nga:

Prof. Dhimitraq Stratobërdha (Kryetar), Dr. Mirjeta Cenaj dhe Doc. Anduela Lile (Anëtarë) në përputhje me detyrat, që u ngarkon Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore të lidhura me punën e NJSBC –ve pranë IAL (UST), bazuar në Plan Veprimin për vitin 2018-2019 ka vazhduar punën për të marrë informacione nga njësitet kryesore, administrata e UST dhe për programet e fakulteteve të UST.

Është punuar me Manualin e ASCAL për të qenë në punën tone konform standardeve të kërkuara, në lidhje me dokumentacionin e kësaj njësie e në përputhje me ligjin e aktet e tjera nënligjore.

Kemi hyrë në fazën e dytë të vlersimeve, që është edhe më e rëndësishmja e që duhet tu përgjigjet standardeve ku do të arrijë cdo IAL.

Konkretisht nga ana jonë, gjatë Janarit, u përgatit një pyetsor për studentët e UST për të tërhequr mendimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programeve të studimit.

Pasi u përgatitën, iu shpërndanë studentëve dhe gjatë muajit Shkurt janë mbledhur pyetsoret nga gjithë programet e UST deri në fillimin e sezonit provimeve, afati kohor lënë deri dt 10.02.2019.

Pyetsoret e ndërtuar në mënyrë të tillë, që të mund të bëhen krahasime me mendimet e opinionet e studentëve vitin e kaluar, gjatë Shkurtit vazhduan të hidhen në sistemin e perpunimit statistikor.

Ky raport është përgatitur sipas pikes 5 të Vendimit nr. 9 më datë 02.03.2018 të Bordit të Administrimit të UST, në mënyrë që të kryhet pagesa mujore për të tre anëtarët e NJSBC.

Kryetari I NJSBC

Prof. Dr. Dhimitraq Stratobërdha